



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

629
30 1 2

V E N D I M

Nr. 51 , datë 25.1.2017

PËR

**MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË KONTRATËN E KONCESIONIT
TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM),
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “GOJAN”, “GJEGJAN”,
“PESHQESH”, “URA E FANIT”, “FANGU””, MIRATUAR ME VENDIMIN
NR.365, DATË 4.5.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit (nr.5446, Rep.nr.1944 Kol., datë 2.5.2011) të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit”, “Fangu””, miratuar me vendimin nr.365, datë 4.5.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Ayen Enerji A.S.” dhe “A.S. energy”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu””, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

~~NIKO PELESHI~~

**MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË**

~~DAMIAN GJIKNURI~~

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 214

NR. 68/1



KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS
“BOT” (Nr.5446 Rep., Nr. 1944 Kol., Datë 02.05.2011, TË NDRYSHUAR, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI”
DHE “AS ENERGY” SH.P.K. PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE GOJAN,
GJEGJAN, PESHQESH, URA E FANIT, FANGU

Në Tiranë, më datë 10, muaji Juor, viti 2017 (dymtë e gjashtëmbëdhjetë), para meje
noteres Shpresa Urdha anëtar i dhomës së Noterisë Shqipëri, me adresë
Soeun Hoshen, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me
autorizimin nr.99/127 Prot., date 13.12.2016, nga znj.Etleva Kondi e datëlindjes [redacted]
madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga [redacted]

DHE

Koncesionari, Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI” dhe “AS
ENERGY” sh.p.k., që në vijim do të quhet koncesionari, i formuar sipas marrëveshjes nr.7360 Kol.,
nr.5768 Rep., datë 19.08.2010 me këto të dhëna:

Shoqëria “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI” dhe “AS ENERGY” sh.p.k. e cila e ushtron
aktivitetin e saj sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me
Vendim Gjykatë të Gjykatës së Ankarasë Nr.79297, datë 16.10.1990, me NIPT nr. 1190045930
përfaqësuar nga Z. Fahrettin Amir Arman, [redacted] madhor dhe me zotësi juridike
për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta me [redacted]

Shoqëria “AS ENERGY” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT
K 81615504 O dhe datë 15.04.2008 regjistrimi, përfaqësuar nga Z.Simon Lala, i datëlindjes
[redacted] madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga ID [redacted]

dhe **Shoqëria koncesionare** “AYEN AS ENERGJI” sha, person juridik shqiptar, regjistruar pranë
QKR me 31.05.2011, me NIPT L11731504A, me përfaqësues ligjor Z. Fahrettin Amir Arman,
shtetas turk, lindur më [redacted] banues në Ankara, Turqi, mbajtës i pasaportës me Nr.
[redacted]

Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë konçesioni, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e Kontratës së Konçesionit të formës "BOT", të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "AYEN ENERJI ANONIM SIRKETT" dhe "AS ENERGY" Sh.p.k., më dt.02.05.2011, me nr.5446 Rep., nr.1944 Kol., "Për ndërtimin e hidrocentraleve "Gojan", "Gjegjan, "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu", miratuar me VKM nr.365, datë 04.05.2011 e ndryshuar me VKM Nr.442, datë 22.05.2013.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërtimi i hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Fangu, me fuqi të instaluar 87.7 MW, është një projekt i rëndësishëm për sektorin e energjisë;
- Në kontratën e Konçesionit të formës "BOT", për ndërtimin e hidrocentraleve "Gojan", "Gjegjan, "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu" në nenin 28 "Ndryshime" cilësohet se:
"28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe /ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve. 28.2. Cdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.";
- Shoqëria AYEN AS ENERGI sh.a., gjatë hartimit të projektzbatimit të objektit i rezultuan zgjidhje më të leverdisshme tekniko ekonomike për ndërtimin e hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu si më poshtë:
 - Reduktimin e numrit të hidrocentraleve nga 5 hidrocentrale "Gojan", "Gjegjan", "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu" që parashikon kontrata me nr.5446 Rep., nr.1944 Kol.,dt. 02.05.2011 e ndryshuar, në 3 hidrocentrale, "Peshqesh", "Ura e Fanit" "Fangu".
- Autoriteti Kontraktues bazuar në projektin e ri është i interesuar për zbatimin e këtij projekti nga ana e koncesionarit, sepse përfitimi është më i lartë si për koncesionarin ashtu edhe për vendin.
- Autoriteti Kontraktues MEI me shkresën nr.99/129 prot., datë 14.12.2016, referuar oponentëve teknike mbi projektin e zbatimit të HEC-eve "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu", të përcjellë nga AKBN me shkresën nr.99/130prot., date 14.12.2016, ka miratuar e projektin e zbatimit të hidrocentraleve "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu".

Palët bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Në kontratën bazë të koncesionit, të formës "BOT", për ndërtimin e hidrocentraleve "Gojan", "Gjegjan", "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu", të miratuar me VKM nr.365, datë 04.05.2011 e ndryshuar, me VKM Nr.442, datë 22.05.2013, kudo në kontratë togfjalëshi: "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës", të zëvendësohet me togfjalëshin: "Ministria e Energjisë dhe Industrisë".



Neni 2

Në pikën 5 të nenit 1 “Përkufizime dhe interpretime”, dhe kudo në kontratë togfjalëshi “Hidrocentralet e “Gojanit, Gjegjanit, Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut” zëvendësohet me togfjalëshin “Hidrocentralet e “Peshqesh”, “Ura e Fanit” “Fangut””.

Neni 3

Neni 3 “Karakteristikat e hidrocentralit” pika 3.1 ndryshohet si më poshtë:

Hidrocentralet Peshqesh, Fangu dhe Ura e Fangut do të ndërtohen në rrjedhën e lumit Fan i Madh dhe Fan i Vogël, Bashkia Pukë dhe Bashkia Mat, me këto karakteristika:

- Hidrocentrali “Peshqesh”	
○ Kuota e veprës së marrjes 1	255 m
○ Kuota e veprës së marrjes 2	255 m
○ Kuota e godinës së centralit	164.35 m
▪ Fuqia e instaluar	34 MW
▪ Prodhim vjetor i energjisë elektrike	118 400 MWh
- Hidrocentrali “Fangu”	
○ Kuota e veprës së marrjes	126 m
○ Kuota e godinës së centralit	33.10 m
▪ Fuqia e instaluar	74.6 MW
- Prodhim vjetor i energjisë elektrike	221 400 MWh
- Hidrocentrali “Ura e Fanit”	
○ Kuota e veprës së marrjes	104.4 m
○ Kuota e godinës së centralit	82.76
▪ Fuqia e instaluar	1.11 MW
Prodhim vjetor i energjisë elektrike	7 446 MWh

Neni 4

Në nenin 7, pika 7.4 ndryshohet si më poshte vijon:

“Për pronat shtetërore që preken nga zhvillimi i projektit hidroenergjetik të HEC-ve të percaktuara në nenin 3 dhe që kanë kaluar në përgjegjësi administrimi të AK, kjo e fundit do të nënshkruajë një kontratë uzufukti me koncesionarin për këto prona.

Për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate, AK do të ndihmojë koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucionet publike.”

Neni 5

Në nenin 8 "Detyrimet e Koncesionarit":

Pika 8.7 zëvendësohet me:

"8.7. Të zbatohet projektin për ndërtimin e hidrocentraleve të Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangu me me një fuqi totale 109.71 MW"

Pika 8.11 ndryshohet si më poshtë vijon:

"8.11. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta, duke përfshirë këtu edhe ndërtimin nga ana e tij të infrastrukturës së demtuar si: Rruge, venddepozitimi mbetjesh urbane etj, që mund të preken nga zbatimi i projektit."

Neni 6

Neni 9 "Vleresimi i investimeve" pika 9.1 ndryshon si më poshtë:

"9.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale 210.184.740 (dyqind e dhjetë milion e njëqindetëdhjetëkatërmijë e shtatëqind e dyzet) euro" sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur.

Neni 7

Në nenin 14 "Sigurimi i kontratës", në paragrafin e parë të pikës 14.1 togfjaleshi "...një shumë prej 680.000.000 lekë (gjashtëqindetëdhjetëmilione leke)" zëvendësohet me togfjaleshin "...një shumë prej 10.509.237 euro (dhjetëmilione e pesëqindentemijë e dyqindetridhjetëeshtate)".

Neni 8

Në nenin 16 "Tarifa Koncesionare", paragrafi i parë, zëvendësohet me paragrafin si më poshtë vijon:

"Koncesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues brenda datës 30 Maj të çdo viti, një tarife koncesionare në energji elektrike të barabartë me 2.1% të prodhimit vjetor të saj, si dhe çdo përfitim tjetër që koncesionari do të ketë, në raport të drejtë me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke u përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë."


Në nenin 16, pika 16.2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"16.2. Duke filluar nga viti i 25-të, nga vënia në punë e HEC-eve, AK ka të drejtë t'i kërkojë koncesionarit, kur është e nevojshme, të riinvestojë në makineri e pajisje me qëllim dorëzimin e tyre në gjendje optimale pune në përfundim të periudhës së koncesionit dhe transferimit të veprës objekt koncesioni të ky i fundit. Ky riinvestim do të bëhet bazuar në praktiken e mirë industriale si dhe në përputhje me kartën teknologjike të makinerive dhe pajisjeve të instaluar, duke garantuar AK për mirefunksionimin e veprës brenda parametrevë teknike të parashikuara në kartat teknologjike të saj, me transferimin tek ky i fundit."

Neni 9

Në nenin 17, në pikën 17.1 në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia e mëposhtme:

“Pëlqimi paraprak i AK, nuk është i nevojshëm për transferimin e aksioneve/kuotave brenda ortakëve të shoqërisë koncesionare, por shoqëria koncesionare është e detyruar të njoftojë me shkrim AK-ne për çdo transferim të aksioneve /kuotave brenda ortakëve të saj.



Neni 10

Kjo shtesë e kontratës së koncesionit do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas nenit 50 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar dhe ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar.

Kontrata Shtesë e koncesionit u hartua në 4 (katër) kopje dhe pasi iu lexua palëve (në prani të perkethyesit të gjuhës turke z. Altin Kodra), të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Përfaqësuar nga:

Znj. Etleva Kondi

KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

“AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI”

Përfaqësuar nga:

AYEN ENERJI A.S.
Z. Fahrettin Amir Arman

“AS ENERGY” sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z. Simon Lala

SHOQËRIA KONCESIONARE

“AYEN AS ENERGI” sha

Përfaqësuar nga:

Z. Fahrettin Amir Arman

NR.PROT.397/1
DATË 20.1. 2017

MINISTRISË SË ENERGISË DHE INDUSTRIË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
AVOKATURËS SË SHTETIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI / 

